



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 200, datë 17.09.2024

PËR

**“PEZULLIMIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL PËR PROKUROREN
ORNELA RRUMBULLAKU”**

Mbështetur në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 97 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 67 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë pezullimin e vlerësimit etik dhe profesional për prokuroren Ornela Rrumbullaku.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet prokurores Ornela Rrumbullaku.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, më 17.09.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Olger Eminaj